



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE  
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

**FUSHA: GJUHË E HUAJ**

**LËNDA: GJUHË SPANJOLLE**

**KODI: 3.6.11.B**

**PROGRAMI I LËNDËS  
GJUHË SPANJOLLE  
PËR KLASËN E 12-TË**

**Koordinatore: Erifili Hashorva**

**Redaktore letrare: Vjola Grillo**

**Përgjegjëse sektori: Marita Hamza**

**TIRANË, NËNTOR 2010**

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 12-të është dokument zyrtar i përpiluar me qëllimin e realizimit të standardeve të mësimdhënies/mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor **B2**, sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

Në kuadrin e ndryshimeve të programeve të shkollave të mesme, me synim përmirësimin dhe përshtatjen me sistemin e ri 3-vjeçar, modernizimin e përmbajtjes së programeve mësimore, zbatimin e një metodologjie më aktive, më pranë interesave të nxënësit, doli si domosdoshmëri hartimi i programit të ri të gjuhës spanjolle për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, klasa e 12-të.

Programi i ri ka pësuar ndryshime të rëndësishme edhe për sa u përket synimeve, objektivave, përmbajtjes dhe shtrirjes së tij. Po ashtu, nga 5 orë mësimore në javë, do të zhvillohen 4. Programi është ndërtuar duke marrë parasysh interesat dhe karakteristikat e grupmohës dhe kontribuon në zhvillimin e pavarur, intelektual e social të nxënësve. Programi synon në formimin e përgjithshëm të nxënësve dhe në zhvillimin e një kulture demokratike në klasë. Formimi gjuhësor do t'u përgjigjet nevojave të nxënësve në kuadrin e një integrimi global në Europë e më gjerë.

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 12-të, ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies/mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit në nivelin gjuhësor B2, sipas tabelës së vlerësimit në kuadrin e përgjithshëm european për gjuhët.

Kështu, programi kërkon që nxënës/i,-ja të rrisë e të thellojë aftësitë e tij/saj formuese dhe shprehëse në gjuhën spanjolle, duke e bërë atë përdorues të pavarur.

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 12-të drejton nxënës/in,-en:

- Të mësojë në mënyrë të pavarur, duke i dhënë atij/asaj besim në vetvete në realizimin e detyrave në klasë e jashtë saj;
- të zhvillojë të menduarit kritik, duke i dhënë mundësi të konsultohet me më shumë burime informacioni dhe të bëjë përzgjedhjen e duhur personale;
- të përgatitet për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Mësimdhënia/mësimnxënia realizohen me sukses dhe duke ndërthurur forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj në grup.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Mësimi i gjuhës spanjolle ka katër synime të rëndësishme, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën:

- Zhvillimin e individualitetit të nxënësit;
- zhvillimin e tolerancës dhe të respektit për shumëllojshmërinë njerëzore dhe kulturore;
- zhvillimin e të nxënëtit të pavarur dhe të mendimit kritik;
- ndërgjegjësimin për identitetin kulturor.

Rezultatet praktike të mëimit të gjuhëve të huaja lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe shkëmbimet kulturore, shkencore e teknike ndërmjet tyre. Mësimi është gjithnjë e më i

individualizuar dhe kontribuon në krijimin e individualiteteve. Duke mësuar spanjishten, nxënësi njih realitete të tjera, i kupton ato më mirë dhe komunikon me folës të tjerë të kësaj gjuhe. Kjo e bën atë më të hapur, zgjeron vizionin, nxit sjellje vlerësimi e respekti ndaj të tjerëve dhe, së fundmi, ngre në një shkallë më të lartë ndërgjegjen e qytetarisë europiane dhe universale.

Në prizmin personal, mësimi i spanjishtes si gjuhë, si kulturë, si realitet social e kulturor do ta ndihmojë atë të zhvillojë kapacitetet njohëse, estetike, kulturore, afektive. Përmes gjuhës, nxënësit tregojnë eksperiencat e tyre, njohin botën dhe kjo i rrit si njerëz krijues, të përgjegjshëm e të sigurt.

Në këtë fazë fillestare të formimit, synimi i gjuhës së huaj është të pajisë nxënës/in,-en me aftësi të reja, të nivelit fillestar, në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë të konsolidojë nivelin B2 dhe të kalojë në nivelin më të lartë. Kjo do të arrihet duke praktikuar aspektet funksionale të përdorimit të gjuhës spanjolle në situata komunikimi.

## **2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM**

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 12-të ka si objektiv të përgjithshëm të zhvillojë aftësinë analitike dhe sintetike të një informacioni më të gjerë gjuhësor dhe kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënës/i,-ja zhvillon më tej:

- Shprehinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të përballuar me shkathtësi dhe saktësi problemet e përditshme përmes formimit të tij/saj gjuhësor dhe kulturor;
- aftësinë për të vënë në dukje, për të krahasuar dhe për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme, si dhe për t'iu përshtatur atyre në situata të caktuara të komunikimit ndërkulturor;
- aftësinë për të ndërthurur sa më mirë kategoritë e njohurive të përgjithshme me ato specifike në përputhje me shprehinë individuale të nxënës/it,-es;
- aftësinë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike, duke konsoliduar shprehinë dhe proceset e të menduarit kritik dhe krijues;
- shprehinë dhe aftësitë planifikuese e përpunuese.

## **3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE**

### **a) Objektiva sipas standardit në komunikim**

*Përshkrimi.* Objektivat e standardeve në këtë fushë japin bazat e gjuhës si domosdoshmëri në komunikim. Objektivi kryesor në mësimin e gjuhëve të huaja është zhvillimi i aftësive komunikuese ose kapaciteti i komunikimit gjuhësor në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme komunikimi shkrim dhe me gojë.

Nëpërmjet situatave të ndryshme gjuhësore, ky standard i mundëson nxënës/it,-et të përfitojnë njohuri gjuhësore të nevojshme për të përballur situata të komunikimit të përditshëm në gjuhën spanjolle.

Standardi	Objektiva
<b>Komunikimi</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të bëjë parashikime;</li> <li>• të ngrejë hipoteza rreth një situatë problemore;</li> <li>• të analizojë;</li> <li>• të vlerësojë;</li> <li>• të përpunojë;</li> <li>• të përzgjedhë;</li> <li>• të ruajë;</li> <li>• të interpretojë;</li> <li>• të miratojë;</li> <li>• të prezantojë informacionin e kërkuar ose të dhënë;</li> <li>• të kuptojë thelbin dhe detajet e bisedës;</li> <li>• të shprehë pikëpamjet mbi një argument, duke e mbështetur me fakte dhe të dhëna;</li> <li>• të krahasojë zgjidhje të ndryshme;</li> <li>• të diskutojë rreth argumenteve pro dhe kundër;</li> <li>• të japë opinione me anë të vlerësimit;</li> <li>• të japë këshilla;</li> <li>• të tregojë për zakonet dhe kulturat e vendeve të ndryshme;</li> <li>• të transmetojë fjalët e një personi tjetër;</li> <li>• të justifikojë mospranimin e një kërkesë ose të një favorit;</li> <li>• të përshkruajë situata të ndryshme.</li> </ul>
<b>Veprimtaritë e komunikimit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të miratojë idetë dhe përvojat e të tjerëve;</li> <li>• të kundërshtojë me argumente, duke përforcuar pikëpamjet e tij/saj rreth temës së debatit;</li> <li>• të formulojë një ankesë duke negociuar për zgjidhjen e saj;</li> <li>• të bëjë hipoteza;</li> <li>• të shprehë dëshirë, keqardhje;</li> <li>• të nxisë marrjen pjesë në shtrimin e një platforme diskutimi, duke krijuar mundësi të njëjta për të gjithë;</li> <li>• të shprehë pëlqime dhe mospëlqime;</li> <li>• të kërkojë falje në situata të jetës së përditshme, si: festa, ditëlindje, në treg, takime, vende të panjohura, shkollë etj.</li> </ul>

## b) Objektivat sipas standardit në kulturë

**Përshkrimi.** Mësimdhënia/mësimnxënia e gjuhëve të huaja ka si objekt zhvillimin e pavarësisë dhe të individualitetit intelektual, shoqëror dhe kulturor të nxënësi. Rezultatet praktike të mësimi të gjuhëve të huaja lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe shkëmbimet kulturore, shkencore dhe teknike ndërmjet tyre. Mësimi nxit krijimtarinë dhe mënyrën alternative të të menduarit, është gjithnjë e më i individualizuar dhe kontribuon në krijimin e individualiteteve.

Standardi	Objektiva
<b>Kultura</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Të njohë kulturën dhe traditën e vendit;</li><li>• të njohë festat dhe zakonet;</li><li>• të përdorë, sipas regjistrave të gjuhës, rregullat e mirësjelljes të popullit spanjoll, gjuhën e të cilit mëson (përdorim i avancuar i urimeve, i përshëndetjeve etj.);</li><li>• të thellojë njohuritë e tij/saj mbi personalitete të ndryshme të kulturës spanjolle, si dhe të ngjarjeve të ndryshme me karakter njohës dhe formues në fushën e gjeografisë, të historisë, të ekonomisë, të politikës etj.;</li><li>• të përdorë saktë shenjat jashtëgjuhësore, si p.sh., gjestet, qëndrimi në ligjërim etj., që përcaktojnë pozicionin e bashkëfolësve në bashkëbisedim;</li><li>• të njohë monumentet e artit e kulturës;</li><li>• të njohë gastronominë spanjolle;</li><li>• të ketë njohuri për vendet ku flitet gjuha spanjolle;</li><li>• të mund të flasë për tregun, për çmimet, për profesionin etj.;</li><li>• të njohë disa nga qytetet më të rëndësishme të Spanjës;</li><li>• të komentojë mbi vlerat e një filmi, një drame, një koncerti apo një veprë letrare, duke i analizuar dhe krahasuar elementet e tyre në sjelljen e personazheve.</li></ul>

## c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor:

**Përshkrimi.** Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të përdorë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B2. Nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës spanjolle, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre, në situata të ndryshme të ligjëritimit.

Nxënës/i,-ja në klasën e 12-të aftësohet të njohë nëse fjalia ose grupi i fjalive është i rregullt nga ana gramatikore, i pranueshëm nga ana kulturore, gjuhësore dhe i përshtatshëm në kontekstin konkret, real.

Standardi	Objektiva
<b>Elemente gramatikore</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të analizojë pjesë leximi, tregimi etj. nga ana gramatikore, për të vlerësuar rrjedhën logjike;</li> <li>• të korrigjojë gabimet e bëra në ligjërime me shkrim ose me gojë;</li> <li>• të njohë ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë; mënyrën lidhore; mënyrën kushtore; mënyrën urdhërore;</li> <li>• të njohë pozicionimin e përemrave në mënyrën urdhërore;</li> <li>• të njohë ndajfoljet dhe lokucionet ndajfoljore të frekuencës;</li> <li>• të njohë fjalitë e nënrenditura lidhore;</li> <li>• të përdorë saktë në mënyrë krijuese foljen në kohë dhe në kombinime të ndryshme;</li> <li>• të përdorë fjalitë kohore me folje në dëftore dhe lidhore;</li> <li>• të njohë shkurtime më të përgjithshme.</li> </ul>

#### 4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
<b>Të dëgjuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndjekë, me pak sforcim, pjesën më të madhe të një bisede autentike të bërë në praninë e tij/saj;</li> <li>• të kuptojë në detaje një ligjërime në gjuhën standarde;</li> <li>• të ndjekë një argumentim apo debat kompleks mbi një temë të njohur dhe të strukturuar qartë;</li> <li>• të kuptojë mesazhet që kanë lidhje me sferat e njohura (informacion personal, shkollë, kohë e lirë, nevoja urgjente), të shprehura qartë dhe jo shpejt;</li> <li>• të kuptojë dokumentarë, intervista apo biseda, drama dhe filma të shprehura në gjuhën standarde;</li> <li>• të përthithë përmbajtjen e një materiali të regjistruar, si dhe të kuptojë pikëpamjen dhe qëndrimin e folësve nëpërmjet elementeve të intonacionit që përdoren;</li> <li>• të nxjerrë informacionin thelbësor nga pjesë ku fliten tema familjare;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>të gjejë shprehjet me kuptim nga këngët, pasi është folur për përmbajtjen.</li> </ul>
<p><b>Të lexuarit</b></p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të përthithë me shpejtësi përmbajtjen dhe domethënien e lajmeve, të artikujve mbi tema që lidhen me interesat e tij/saj dhe të vendosë nëse një rilexim është i domosdoshëm;</li> <li>të kuptojë artikuj dhe materiale mbi problemet aktuale, ku shprehen qëndrime dhe pikëpamje të caktuara;</li> <li>të kuptojë në detaje tekste të ndryshme, që lidhen me fushën e tij/saj të interesit akademik dhe shoqëror;</li> <li>të përmbledhë pikat kryesore në shkrimet kritike rreth filmave, teatrove, librave dhe koncerteve;</li> <li>të përshkojë shpejt një manual rreth një problemi të caktuar;</li> <li>të identifikojë shpejt përmbajtjen, duke përzgjedhur informacionin e përshtatshëm nga artikuj dhe reportazhe, si dhe duke vendosur nëse i duhet një studim më i thellë;</li> <li>të kuptojë artikuj të specializuar jashtë fushës së tij/saj, duke e lejuar që t'i referohet herë pas here fjalorit, për të verifikuar kuptimin;</li> <li>të kapë mesazhin thelbësor në korrespondencën e përditshme të fushës së tij/saj të interesit.</li> </ul>
<p><b>Të folurit</b></p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të shprehet rrjedhshëm dhe saktë për një shumëllojshmëri temash, duke bërë me lehtësi lidhjen midis ideve;</li> <li>të komunikojë rrjedhshëm dhe spontanisht gjatë bashkëbisedimit me folës vendës, duke mbështetur qëndrimet me anë të argumenteve dhe shpjegimeve të nevojshme;</li> <li>të kuptojë hollësisht, duke marrë pjesë në biseda të zgjedhura për çështje të përgjithshme;</li> <li>të shprehë idetë e tij/saj në mënyrë të saktë;</li> <li>t'u përgjigjet argumenteve komplekse në mënyrë bindëse;</li> <li>të evidentojë problemet, duke vlerësuar propozimet alternative;</li> <li>të bëjë hipoteza, duke u përgjigjur në lidhje me tema, përmbajtja e të cilave është e njohur;</li> <li>të mbështesë mendimet e tij/saj në diskutime, duke dhënë</li> </ul>

	<p>shpjegimet, argumentet dhe komentet e duhura;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përballojë një debat duke identifikuar qartë argumentet në mbështetje apo kundër pikëpamjes së tij/saj;</li> <li>• të përballojë duke negociuar për zgjidhjen e një problemi që ka ngjallur debat;</li> <li>• të tregojë për eksperiencat e kaluara dhe projektet e së ardhmes përmes shprehjeve kohore, madje në vijueshmëri;</li> <li>• të raportojë informacione dhe argumente nga një numër burimesh, si dhe të arrijë në përfundimet e duhura;</li> <li>• të bëjë përshkrime dhe prezantime të qarta dhe të detajuara, duke parashtruar idetë e rëndësishme dhe duke i mbështetur me shembujt e duhur;</li> <li>• të japë qartë e rrjedhshëm njoftime për çështje të përgjithshme, pa shkaktuar keqkuptime dhe vështirësi të dëgjuesi.</li> </ul>
<p><b>Të shkruarit</b></p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë qartë tekste (esë, raport, prezantim etj.) rreth temave të ndryshme, që kanë lidhje me interesat e tij/saj;</li> <li>• të përmbledhë informacione dhe argumente nga burime dhe t'i vlerësojë ato;</li> <li>• të përshkruajë saktë përmbajtjen e një libri ose një filmi, duke dhënë mendimin e tij/saj vetjak;</li> <li>• të shtjellojë një temë nëpërmjet esësë apo raportit, duke theksuar pikat kyçe dhe duke përfshirë në të detajet mbështetëse;</li> <li>• të shkruajë raporte rreth një situatë të caktuar, duke parashtruar mendimet e tij pro dhe kundër;</li> <li>• të raportojë mbi lajmet e ditës, duke shprehur qëndrimet rreth tyre;</li> <li>• të vlerësojë ide dhe zgjidhje të ndryshme për një problem, duke shpjeguar qartë avantazhet apo disavantazhet e varianteve të ndryshme;</li> <li>• të kërkojë, përmes medias elektronike, informacionin e nevojshëm.</li> </ul>



## 5. KËRKESA TË GJUHËS SPANJOLLE NDAJ LËNDËVE TE TJERA

Programi i gjuhës spanjolle në klasën e 12-të e sheh mjaft të rëndësishëm integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin e nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore.

Shohim lidhjen e spanjishtes me matematikën e shprehur në mësimin e shifrave dhe të numrave, në veprimet me këmbimin e parasë ose blerjet në treg.

Shohim lidhjen e spanjishtes me shkencat sociale, nëpërmjet temave si: njohja, familja, festat, profesioni, punësimi, papunësia etj.

Shohim lidhjen e spanjishtes me shkencat natyrore, p.sh., me biologjinë, nëpërmjet trajtimeve të temave që kanë të bëjnë me ushqyerjen, recetat e gatimit, përgatitjen e menysë etj.

Shohim lidhjen e spanjishtes me artin, që reflektohet ngushtë në temat për sportin, për muzikën, për modën, për pikturën etj.

Trajtimi ndërlëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe të nënlinjave të tij, kryesisht për:

Njohuritë që merren në gjuhën spanjolle dhe në *matematikë*, ndërthuren kur përdoren shifrat, numrat dhe veprimet matematikore në interpretimin e disa të dhënave në përqindje, në diferencë etj.

Njohuritë që merren në gjuhën spanjolle dhe në shkencat natyrore, p.sh.: në *biologji*, *kimi*, *fizikë* reflektohen në trajtimin e temave rreth funksionit të trupit të njeriut, të reaksioneve kimike, si dhe të zbatimit të ligjeve të fizikës.

Në lëndën e TIK-ut, nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë internetin, *e-mail*-in, programe të ndryshme që e ndihmojnë atë të eksplorojë të rejat mbi botën që ai/ajo studion, si dhe të vendosë komunikim me bashkëmoshatarët e tij/saj.

Njohuritë që ai/ajo merr nëpërmjet artit dhe kulturës spanjolle, gjejnë shprehjen e tyre në aktivitetin dhe në kontributin e personaliteteve në fushën e sportit, të muzikës, të modës dhe të pikturës.

Me *shkencat sociale* janë të lidhura tema, si: marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, marrëdhëniet në komunitet, të cilat vihen në zbatim përmes projekteve ndërkurrikulare mbi ndihmën ndaj të varfërve, të moshuarve dhe ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Bashkërendimi ndërlëndor në programin e klasës së 12-të mundëson realizimin e synimeve dhe të objektivave të përgjithshëm të programit për:

*Edukimin intelektual.* Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme, nxënësit arrijnë të krahasojnë, të kundërshtojnë, të dallojnë dhe të hamendësojnë, duke rritur cilësinë e nxënies.

*Edukimi mjedisor.* Ndotja, mbrojtja e ambientit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore të thjeshta, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

*Edukimi kulturor dhe etik.* Përmes lëndëve historie dhe gjeografi, nxënësit fitojnë njohuri mbi vendet spanjishtfolëse. Këto njohuri bazë ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtyre vendeve, zakonet e doket e tyre, mënyrën e jetesës etj., shtuar këtu edhe shprehitë etike të këtyre popujve.

*Edukimi për të drejtat e njeriut.* Njohja e kulturave të vendeve spanjishtfolëse trajtohet ngushtë me temat e barazisë sociale e gjinore.

*Atdheshurinë.* Njohja me historinë, personalitetet dhe kulturën e vendeve spanjishtfolëse i jep mundësi nxënës/it,-es të bëjë dallimin dhe të nxjerrë anët e përbashkëta, duke e ndërgjegjësuar atë për identitetin kombëtar dhe kulturor.

## 6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës spanjolle. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës. Programi i klasës 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës spanjolle në nivelin B2. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

### A. Objektivat

Objektivat e parashtruara në programin e gjuhës spanjolle për klasën e 12-të janë të detyrueshme për t'u realizuar nga mësuesi dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Objektivat janë të detyruara të zbatohen sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqenëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, atëherë mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënësit e tij/saj. Kjo kërkon që, përveç përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, të përcaktojë objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

### B. Orët mësimore

Në program janë përcaktuar objektivat për çdo aftësi, për të cilat mësuesi do të punojë për t'i arritur në përfundim të vitit shkollor në këtë lëndë.

Mësuesi duhet të respektojë sasinë e orëve vjetore të lëndës të përcaktuara në program. Ai është i lirë të ndryshojë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Kjo në varësi të përparimit të nxënësit në tema të caktuara.

Në programin e gjuhës spanjolle, afërsisht 70% e orëve mësimore shërbejnë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30 % e tyre për përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

#### **Shpërndarja e orëve**

Gjuha spanjolle për klasën e 12-të zhvillohet me 4 orë mësimore në javë:

**34 javë x 4 orë = 136 orë mësimore vjetore.**

Shpërndarja e orëve është parashikuar si më poshtë:

**Komunikimi dhe formimi kulturor zë 104 orë**, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 90 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70%, që përbëjnë 63 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30%, që përbëjnë 27 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforsimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 14 orë për aktet dhe

funkcionet e komunikimit (70%, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30%, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. u jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

**Formimi gjuhësor zë 32 orë.** Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 23 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin).

### **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një kapitulli (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve pararendës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Edhe pse ky integrim do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimi, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e veçantë);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja njësi mësimore ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar)

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive dhe aftësive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'u kushtohet vëmendje dhe kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si p.sh., të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore, të të menduarit kritik dhe krijues;
- kultivimit të aftësive të posaçme lëndore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si p.sh., qëndrimi etiko-social dhe ai gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë detyra tematike nga jeta e përditshme, projekte kurrikulare etj.

## **Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies**

Mësues/i,-ja është i/e lirë të përdorë larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/nxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai/a jo i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen në përmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë për katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

### **Të dëgjuarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- të arsyetojë mbi atë që dëgjon;
- të përdorë njohuritë e tij/saj të mëparshme;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- të përpiqet që, gjatë dëgjimit, të kuptojë referencat kulturore, jo të njohura për të, duke përdorur kontekstin për të hamendësuar se kujt i referohen ato.

### **Të folurit**

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit të përsërisë atë që sapo ka thënë, në rastet kur nuk e ka kuptuar;
- t'u përgjigjet pyetjeve saktë dhe shkurt;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- të ndërhyjë në një bisedë shkurt dhe me fjali të thjeshta, por me kuptim;
- t'u përgjigjet pyetjeve saktë dhe shkurt.

### **Të lexuarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të lexojë tekstin për herë të dytë, që të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme;
- të gjejë në tekst përgjigjet e pyetjeve, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;

- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor;
- të përdorë përshkrimin me fjalë të njohura, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë;
- të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin.

## **Të shkruarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin e dëgjuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të plotësojë paragrafë duke përdorur fjalët e munguara.

## **C. Parime për zbatimin e programit**

### **Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes**

Programi merr parasysh nxënës/in,-en njohuritë e tij/saj, aftësitë e grupmohës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo reflektohet, së pari, në përzgjedhjen e temave që trajtohen, së dyti, në përdorimin e strategjive që e nxisin nxënësin të veprojë me gjuhën, së treti, në përfshirjen e tij në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përfutuara.

### **Krijimi i mjedisit të të nxënës**

Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, ku nxënës/i,-ja ndihet i/e sigurt, mundëson një mësimdhënie/mësimnxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

### **Organizimi i klasës**

Mësues/i,-ja përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimin mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi apo lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësues/i,-ja, ashtu dhe nga nxënësit e tjerë. Nxënës/i,-ja, ndërkohë, mëson edhe nga shokët/shoqet e tij/saj. Herë pas here, nxënës/i,-ja punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Nxënësit, gjatë orëve të gjuhës së huaj, shpesh nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë atyre më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e

rrjedhshëm dhe zhvillojnë shkathtësi sociale. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë punën dhe përgjegjësitë.

### **Përdorimi i gjuhës në klasë**

Gjuha spanjolle është mbizotëruese gjatë orës së mësimit. Mësuesi, që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës spanjolle në klasë, minimizon në maksimum përdorimin e gjuhës amtare.

### **Të mësuarit e gramatikës**

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të nxënies, ekspozohen ndaj dukurive të reja gramatikore.

### **Korrigjimi i gabimeve**

Gabimet duhet të qortohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe qortimet e mësues/it,-es, të shokëve ose shoqeve dhe të vetë nxënës/it,-es ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe respektin për veten. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e iniciativës, heqjen e dëshirës për të folur, çmotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimit. Mësuesi ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme, qorton më shpesh kur nxënës/it,-et praktikojnë strukturat gramatikore dhe, më rrallë, kur nxënës/it,-et janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

### **Puna e diferencuar me nxënësit**

Me qëllim që metodat e mësimdhënies/mësimnxënies dhe parimet e strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda, të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Niveli i formimit të aftësive të nxënësve që i nënshtrohen programit të gjuhës spanjolle të klasës 12-të, nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit. Arritja e rezultateve të kërkuara nga programi për të gjithë nxënësit kërkon që mësuesi të marrë parasysh nivelet e ndryshme që ekzistojnë në klasë. Kjo gjë ndodh për arsye objektive ose subjektive. Prandaj, mësuesi planifikon punën e tij të diferencuar lidhur me metodat e mësimdhënies, me ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor, si dhe me format e ndryshme të vlerësimit.

Mësues/i,-ja njihet mirë që në fillim me përbërjen e klasës së tij/saj dhe me problemet që kanë nxënës/it,-et. Mësuesit,-et kanë të bëjnë me adoleshentë dhe, për këtë arsye, ata ndeshen edhe me

shumë probleme të moshës së tyre, si: temperament impulsiv, të ashpër në komunikim, ndonjëherë agresiv, dorëzim para një detyre të dhënë etj.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënës/it,-et në mësim, mësuesi duhet të përdorë disa *forma didaktike*, si:

- Të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë, atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.

Nxënësit kanë nevojë për një siguri profesionale dhe njerëzore në klasë, prandaj mësuesi përdor metoda të larmishme dhe gjithëpërfshirëse demokratike, duke siguruar një mjedis të rregullt brenda normave dhe rregullave të shkollës.

## **7. VLERËSIMI**

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por dhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur, duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e.

Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

*Vlerësimi i dijeve* (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me çfarë është mësuar gjatë një jave, një muaji ose një semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijës është i bazuar në orën e mësimin. Kështu ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm.

*Vlerësimi i kapaciteteve* (ose i zbatimit të aftësive ose i performancës), që është vlerësimi i asaj që nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: eksperimenton, prodhon një maket etj.

*Vlerësimi me shkrim dhe me gojë* klasifikohet në:

*Vlerësim formues*, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

*Vlerësim diagnostikues*, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/mësimnxënies.

*Vlerësim i planifikuar*, që bëhet mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

*Vlerësim motivues*, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës spanjolle. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

*Vlerësim përfundimtar*, që është vlerësim me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe të nënlinjave për këtë grupmoshë.

*Vlerësim me notë* i grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk është i detyruar të vlerësojë me notë të nxënësve dhe të vendosë nota në regjistrë për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimin të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe rreth kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, mësuesi përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet për një objektive të veçuar të të nxënësit, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.



## **Vetëvlerësimi**

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës spanjolle, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi dhe nga provimet. Vetëvlerësimi ka efekt, kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmohën dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program, mundëson vetëvlerësimin në vazhdimësi.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas, mësues/i,-ja dhe nxënës/it,-et bëjnë komentin përfundimtar.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.